



ESE HISTORIKE

TEMA:KRIMET NAZISTE NDAJ SHQIPËTARËVE

PUNOI:ELENA KOÇO

KLASA:11-7

GJIMNAZI:SAMI FRASHËRI

Nazizmi është një ideologji politike e lindur në Gjermani nga ardhja në pushtet e partisë naziste në vitin 1933 deri në humbjen ushtarake të ushtrisë gjermane në vitin 1945, ku asaj iu ndalua veprimi në vendin e saj të origjinës. Një ditë e shënuar në kalendarin historik është dhe data e 27 janarit e vitit 1945 që njihet si Dita Ndërkombëtare Të Kujtesës së Holokaustit, në nder të milionave viktimave të gjenocidit të Gjermanisë naziste, krime që u kryen gjatë Luftës së Dytë Botërore. Gjatë kohës që kjo ideologji ishte e lejuar të kryente lëvizjet e saj, nazistët kanë kryer krime të cilat janë kthyer në një histori tmerruese për shumë popuj dhe një ndër to janë dhe shqipëtarët.

Nazistët kanë kryer shumë makabra të cilët kanë marrë mijëra e miliona vetë të pafajshëm. Një ndër krimet më të mëdha dhe më e përhapur në Shqipëri është Masakra e Boroves. Kjo ngjarje ndodhi në një fshat në jug të Shqipërisë të quajtur Borova. Në datën e 6 korrikut 1943, nazistët u zhvendosën në vendsynimin e tyre për hakmarrje ndaj partizanëve, Borove. Ata e kryen masakrën në mesin e popullatës civile, kanë qëlluar dhe vrarë njëez. Borova në atë periudhë kohore kishte afërsisht 450-500 banorë. Të gjithë këta banor dhe 100 objektet e fshatit u vendosën në përdorim për ushtarët e djegur ose të dëmtuar rëndë për shkak të përleshjes me nazistët. Numri i viktimave në këtë ngjarje arriti në 107 ku mes tyre kishte civile, gra, fëmijë e të moshuar. Sipas të dhënave historike thuhet se 47 prej viktimave ishin më të rinj se 20 vjeç, 23 mbi moshën 60 vjeç, 37 mbi 25 vjeç dhe viktimat më të reja ishin vetëm katër muajsh.

Një ngjarje tjetër është dhe ajo e Mauthausen, një kamp përqëndrimi nazist i cili ishte i vendosur pranë fshatrave të Mauthausen dhe Gusen në Austri. Një ndër kampet më të famshëm për shkallën e lartë të vdekjeve. Numri i shqipëtarëve të dënuar në kamp ishte diku te 400, ndërkohë mendohet se shumica e shqipëtarëve kanë vdekur në këtë kamp. Në vitet 1943-1945 nazistët arrestuan në Shqipëri rreth 530 vetë kryesisht në Vlorë, Durrës, e Tiranë dhe i nisën në burgjet e Prishtinës, Zemunit e Bajnicës në Jugosllavi dhe më pas në kampet e përqëndrimit Mauthausen. Sipas të dhënave të kampit figuron se aty kanë hyrë 427 shqiptarë, nga të cilët mbijetuan vetëm 24 persona. Ku 8 persona kanë dëshmuar për këtë eksperiencë të keqe në jetën e

tyre.

*“Na dërguan në stacionin e trenit të Beogradit, duke na futur në vagonë të mbyllur mallrash, në të cilat nuk mund të shikoje asgjë jashtë. Brenda në to ishte shumë ngushtë dhe nuk mund të qëndroje veç në këmbë. Po kështu dhe prej vapës të merrej fryma. Udhëtimi zgjati pothuajse një javë dhe rrugës për në Mauthausen vdiqën dy shqiptarë.” (Beqir Xhepa, i mbijetuar i kampit).*

**Kjo është një ndër dëshmitë e të mbijetuarve të kampit Mauthausen. Bëhen të ditur emrat e disa të mbijetuarve të këtij krimi, të cilat janë: Beqir Xhepa, Vangjel Doni, Abdulla Krutani, Gaqo Como, Agmet Cekaj, Mehmet Agalliu, Stefan Konduri.**

**Shumë vende, shumë persona kanë vuajtur prej kësaj ideologjie. Disa prej tyre u dënuan në mënyrë tepër makabre që ndoshta as nuk e meritonin të kishin një vdekje të tillë. Vitet kalojnë por plagët që këto ngjarje kanë lënë në shoqërinë tonë janë duke u shëruar. Megjithatë ne nuk duhet ta harrojmë kurrë dhimbjen që ato na bënë të ndjejmë dhe nëse dikush mundohet të shkaktojë dicka të atillë përsëri, është detyra jonë që të luftojmë kundër tyre!**